

"Gjuha dhe kultura ruse në Shqipëri"

25 mars 2024; Aktivitet i Grupit Mësimor Kërkimor i Degës së Gjuhës Ruse

Dega e Gjuhës Ruse organizoi një takim kulturor dedikuar artit, gjuhës dhe kulturës ruse në Shqipëri, i cili u zhvillua në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja. Takimi ishte i mbushur me copëza jete nga eksperiencia personale, të frytshme dhe mbresëlënëse e të ftuarve tanë, të cilët na nderuan me ardhjen e tyre si Maestro Oleg Arapi (dirigjenti i skenave ndërkombëtare) dhe përkthyesi i njohur i gjuhës ruse z. Shpëtim Çuçka.

Përveç studentëve të gjuhës ruse dhe degëve të tjera në aktivitet ishin te pranishëm dhe nxënësit e gjimnazit me profil gjuhësor "Asim Vokshi" në Tiranë, të cilët studiojnë me pasion gjuhën ruse. Ata shfaqën interes ndaj ligjëratave të të ftuarve tanë.

Prof.Çuçka foli mbi mesazhet ideore, estetike, edukative të gjuhës dhe kulturës ruse. Nëpërmjet gjuhës te lexuesi dhe përdoruesi i saj kultivohet ndjenja e rregullit, e qartësisë dhe e bukurisë në të shprehurit e qytetarëve dhe në tërësi në sjelljen shoqërore, në jetën shoqërore.

Maestro Oleg Arapi theksoi rëndësinë e të përjetuarit dhe të kuptuarit të thellë të kësaj kulture. Ai vlerësoi kontributin e artit rus në skenën ndërkombëtare, duke përmendur mjeshtërinë e kompozitorëve, artistëve të famshëm rusë.

Ky takim përcolli mesazhe të vyera tek studentët për rëndësinë studimit e gjuhës dhe kulturës së Pushkinit, Dostojevskit, Gogolit ... etj.

